AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-176/1

Në bazë të neneve Neni 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullat e Përgjithshme të Tenderit për shitjen e aseteve ne likuidim dhe Procedurave të shitjes për shitjen e aseteve ne likuidim, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit përmes procedurës me shkrim sipas nenit 10.6 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me datë 09 Shkurt 2023 nxjerr këtë:

VENDIM

I. **Aprovohet lista e aseteve për shitje në SHAL 62 me gjithsej 25 asete dhe me gjithë depozitat e propozuara.**
II. **Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Me datën 09 Shkurt 2023, përmes procedurës me shkrim sipas nenit 10.6 të Statutit të Bordit, Bordi shqyrtoi dhe aprovoi kërkesën urgjente të Menaxhmentit për aprovim të Shitjes se Aseteve përmes Likuidimit SHAL 62 sipas udhëzimeve ne mbledhjen e kaluar te Bordit te datës 27.01.2023. Andaj Bordi i AKP-së në zbatim të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së të datës 08 Shkurt 2023 dhe materialeve përcjellëse, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:
Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 09 Shkurt 2023.

Syzana Dautaj Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

LISTA E ASETEVE PËR SHITJE TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE NË URIDIM
MIRATUAR NGA BORDI I DREJTORËVE NË MBLEDHJEN E MBAJTUR MË: SHKURT 2023

Numri i rolit: SHAL62
Data e paraqitjes për dorëzimin e ofertave: 19.03.2023

Regjioni	Nr. I aseteve	depo	Zyre	Lokal	Lokal dhe tokë	Ndërtesa Administrative dhe tokë	tokë ndërtimore	Tokë bujqësore	tokë
Gjilan	2	0	0	1	0	1	0	0	0
Mitrovica	7	1	0	5	0	0	0	1	0
Peja	3	0	0	0	0	0	1	1	1
Prishtina	5	0	1	4	0	0	0	0	0
Prizren	8	0	0	7	1	0	0	0	0
Gjithsej	25	1	1	17	1	1	1	2	1

Miluf
08.2.2023

Nr	Regjioni	AKP ID	Aset ID	AKP Asset ID	Emri i NSH-së	Fi nr.	Emri i Asetit	Kategoria e asetit	Nënkategoria e asetit	Klasa e Tokës	Pershkrimi i shkurter i asetit	Komuna	Lokacioni (fshati, Qyteti)	Ritenderim	Sipërfaqja e objektit m^2	Sipërfaqja e tokës m^2	Deposita e ofertës Vendim i Bordit	Kriteret për përzgjedhjen e aseteve për shitje: Aset i ndërmarrjes qe kane nr te vogel te aseteve me qellim te permbylljes se NSH-se	Aset pa probleme /pengesa juridiko-pronesore	Aset per te cilin ka pasur interesim nga investitoret	Vërejtje	Ritenderimet
														23	1,846	4,762						
1	Gjilan	GJI005	4	GJI005/4	Kualiteti	Fi-888/89	Kualiteti Lokali në Gjilan	Lokal	Objekti i fortë		Kualiteti Lokali në Gjilan	Gjilan	Gjilan	1	86.12		€ 3,500		1		Për këtë njësi është mar mesatarja e çmimit për m^2 të shitjes së lokalit në komunën e Gjilanit. Bazuar në matjet interne të AKI"-së (me laser/metër), sipërfaqja e lokalit është 86.12m^2, ndërsa sipas evidencës se ofruar nga menaxmenti i ndermarrjes (lista e aseteve), lokali ka sipërfaqe prej 77,52m^2	SHAL 55 refuzim nga Bordi, SHAL 59 refuzim nga Bordi, Refuzim nga Bordi SHAL 61
2	Gjilan	GJI142	1	GJI142/1	KB Novoberda	Fi-1584/90	KB Novobërda Toka dhe Objekti	Ndërtesa Administrative dhe tokë	Objekti i fortë		Objekti dhe toka me parcelën kadastrale nr. 00123/0	Novobërdë	Josenovik	1	209.00	11,645	€ 10,000		1		Për këtë njësi është mar mesatarja e çmimit për m^2 të shitjes së tokave në komunat e Kaçanikut, Gjilanit dhe Kamenicës .	SHAL 55 refuzim nga Bordi, SHAL 58 pa oferta, Refuzim nga Bordi SHAL 61.
3	Mitrovica	MIT001	11	MIT001/11	IMB	709/89	IMB Lokali 10 në Tunelin e parë	Lokal	objekt i fortë		IMB Lokali 10 në Tunelin e Parë ka sipërfaqe prej 56.4m^2 sipas matjeve në terren, ndërsa sipas listës se aseteve ka sipërfaqe prej 55m^2. Lokali është njësë atashore e një ndërtese afariste-banesore në Tunelin e Parë.	Mitrovica e Jugut	Mitrovicë	1	56.40		€ 5,000		1			Pa oferta në SHAL 59
4	Mitrovica	MIT039	4	MIT039/4	Lux	Fi 200/89	Lux Lokali Rudar në Tunelin e Parë	Lokal	Objekti i fortë		Lokali i Lux-it "Rudar" në Tunel i Parë ka sipërfaqe prej 50m^2, sipas dokumenteve të posedimit, gjegjësisht listës së aseteve të Ndërmarrjes, ndërsa sipas matjeve në terren, lokali ka sipërfaqe prej 78.00m^2. Nuk ka tokë që transferohet tek blerësi.	Mitrovica e Jugut	Fshat	1	78.06		€ 5,000		1		Prona e përfshirë në këtë shitje aktualisht është e mbyllur (e pashfrytëzuar) në gjendje jo të mirë.	SHAL53, SHAL 57 pa oferta, Refuzim në SHAL 60
5	Mitrovica	MIT039	16	MIT039/16	Lux	Fi 200/89	Lux Vetëshërbimi Tunell në Tunelin e Parë	Lokal	Objekti i fortë		Lokali i Lux-it "Vetëshërbimi Tunel" në Tunelin e Parë ka një sipërfaqe prej 151m^2, sipas dokumenteve që posedojmë, gjegjësisht listës së aseteve të Ndërmarrjes, ndërsa sipas matjeve në terren, lokali ka sipërfaqe prej 168m^2. Nuk ka tokë që transferohet tek blerësi i ri.	Mitrovica e Jugut	Fshat	1	168.00		€ 5,000	1	1		Prona e përfshirë në këtë shitje aktualisht është e mbyllur	SHAL28, SHAL 57 pa oferta, Refuzim në SHAL 60
6	Mitrovica	MIT042	10	MIT042/10	Çyçavica	Fi 632/89	Çyçavica Lokali Lasta në Prelluzhë	Lokal	Objekti i fortë		Lokali i Çyçavicës "Lasta" i cili gjendet në fshatin Prelluzhë të Vushtrrisë, sipas listës së aseteve të Ndërmarrjes, ka sipërfaqe prej 63m^2, ndërsa sipas matjeve në teren lokali ka sipërfaqe prej 66 m^2. Nuk ka tokë që do të transferohet tek investitorët potencial.	Vushtrri	Fshat	1	66.00		€ 5,000	1	1		Prona e përfshirë në këtë shitje, aktualisht nuk është në shfrytëzim. Çelësat e lokalit gjenden në ZR Mitrovicë.	SHAL34, SHAL 57 pa oferta, Pa oferta SHAL 60
7	Mitrovica	MIT042	11	MIT042/11	Çyçavica	Fi 632/89	Çyçavica Lokali Sitnica në Prelluzhë	Lokal	Objekti i fortë		Lokali i Çyçavicës "Sitnica" i gjendet cili është në fshatin Prelluzhë të Vushtrrisë, sipas listës së aseteve të Ndërmarrjes, ka një sipërfaqe prej 64 m^2, ndërsa, sipas matjeve në teren lokali ka sipërfaqe prej 62 m^2. Nuk ka tokë që do të transferohet tek investitorët potencial	Vushtrri	Fshat	1	62.00		€ 5,000	1	1		Prona e përfshirë në këtë shitje, aktualisht nuk është në shfrytëzim. Çelësat e lokalit gjenden në ZR Mitrovicë.	SHAL34, SHAL 57 pa oferta, Pa oferta SHAL 60
8	Mitrovica	MIT002	8	MIT002/8	KB Agrokultura	1604/90	Agrokultura Depo në Bare	depo	objekt i fortë		Depoja në fshatin Bare, sipas dokumentacionit të posedimit faturës së tatimit në pronë ka sipërfaqe prej 175 m^2, ndërsa, sipas matjeve në terren objekti ka sipërfaqe prej 167 m^2.	Mitrovica e Jugut	Fshati Bare	1	167.00		€ 3,500		1		Prona eshte e zbrazte dhe e pashfrytezuar. Siperfaqja sipas matjes ne terren.	Pa oferta SHAL 55, SHAL 57 pa oferta, Pa oferta SHAL 60
9	Mitrovica	MIT025	18	MIT025/18	NSH Kosovasirovina	674/89	Kosovasirovina Parcela 04208-3 në Gjakovë	Tokë bujqësore	Arë		Kosovasirovina Parcela 04208-3 në Gjakovë, sipas Certifikatës së Pronës ka sipërfaqe prej 1600m2 e regjistruar si tokë bujqësore arë e klasës së tretë. Parcela ndodhet në veri te qytetit të Gjakovës, në një zjesë rejaftill aktive në aspektin biznesor.	Gjakovë	Qytet			1,600	€ 15,000				Aset i identifikuar gjate vitit 2022 kur per parcelën në fjalë ka pas një kërkesë për blleje me negocim direkt.	
10	Peja	PEJ029	200	PEJ029/200	NSH Ereniku - Prodhimtaria Primare	Fi.460/89	Parcela nr. 941-2 në ZK Dujakë	tokë bujqësore	arë	1	Parcela nr. 941-2 me sipërfaqe prej 1181m^2 (11 ari 81 m^2)	Gjakovë	Dujakë	1		1,181	€ 5,000		1		Mungon ndarja grafike e parcelës.	Pa oferta ne SHAL 59
11	Peja	PEJ172	87	PEJ172/87	NPB Malishgani	Fi.265/90	Parcela nr. 199/3 në Dranashiq	tokë	arë	4	Parcela nr 199-3 në ZK Dranashiq ne sipërfaqe totale 15 ari 66 m^2 (1566 m^2)	Klinë	Dranashiq	1		1,566	€ 5,000		1			SHAL 57 pa oferta, Pa oferta SHAL 60
12	Peja	PEJ319	75	PEJ319/75	NT 17 Nëntori	Fi 549/85	Parcelat nr. 252-2 dhe 252-3 afer Qendres Zejare ne Peje	tokë ndërtimore	shoh/zjeëllore		Parcelat nr 252-2 dhe 252-3 afer Qendres Zejare ne Peje me sipërfaqe totale prej 3 ari 01 m^2 (301 m^2)	Pejë	Pejë			308	€ 15,000				Pronësia mbi këtë aset është fituar me Aktgjykim të GJTH Pejë. Ky aset më herët nuk ka qenë I futuar në listëne aseteve të mbetura meqë kemi prit deri sa të bëhet i plotfuqishëm Aktgjykimi.	

AGENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Nr	Regjioni	AKP ID	Aset ID	AKP Asset ID	Emri i NSH-së	Fi nr.	Emri i Asetit	Kategoria e asetit	Nënkategoria e asetit	Klasa e Tokes	Përshkrimi i shkurtër i asetit	Komuna	Lokacioni (fshati, Qyteti)	Ritenderim	Sipërfaqja e objektit m^2	Sipërfaqja e tokës m^2	Depozita e ofertës Vendim i Bordit	Aset i ndermarrjes qe kane nr te vogel te asteve me qellim te permbylljes se NSH-se	Aset pa probleme /pengesa juridiko-pronesore	Aset per te cilin ka pasur interesim nga investitoret	Vërejtje	Ritenderimet
13	Prishtina	PRN171	2	PRN171/2	BVI PËR MBROJTJE KUNDËR BRESHËRIT	FI.428/78	BVI Për Mbrojtje Kundër Breshërit Lokali në Dardani	Lokal	Objekti i fortë		Lokal afarist nën objektin banesor	Prishtinë	Prishtinë	1	116.70		€ 15,000	1	1		Lidhur me lokalin ne fjale eshte duke u zhvilluar proces gjyqësor, mirepo nuk ka vendim te plotfuqishem te gjykates apo masa te perkohshme qe e pengon shitjen.	Refuzim ne SHAL 59
14	Prishtina	PRN051	1	PRN051/1	Separacioni i gurëve Gadime	Fi.-416/87	Asetet e Gurëthyesit Gadime	Zyre	objekt i fortë		Lokal/objekt i fursë	Shtime	Gadime	1	269.92		€ 15,000	1				PA OFERTA SHAL 24, PA OFERTA SHAL 56, Pa oferta ne SHAL 59.
15	Prishtina	PRN130	5	PRN130/5	TURIST KOSOVA	FI.691/89	Turist Kosova Lokali në Mitrovicë	Lokal	Objekti i fortë		Lokal afarist nen objektin banesor	Mitrovica e Jugut	Qytet	1	60.00		€ 15,000	1	1		AKP-ja nuk posedon dokumente pronësore. Fatura e tatimit në pronë është në emër të Turist Kosova. Në faturën e tatimit në pronë sipërfaqja eshte 54m2, ndersa ne baze te matjeve siperfaqja eshte 60m2.	SHAL 60 Refuzim BD
16	Prishtina	PRN113	5	PRN113/5	IMB MULLIRI	FI.707/89	Mulliri Lokali në Obiliq	Lokal	objekt i fortë		Shitorja ne Obiliq	Obiliq	Obiliq	1	114		€ 7,000	1	1		Sipërfaqja e lokalit sipas matjeve 114m² ndersa sipas kontratës 120m²	Refuzim nga Bordi SHAL 55, SHAL 58 refuzim nga Bordi, Refuzim nga Bordi SHAL 61.
17	Prishtina	PRN103	21	PRN103/21	Urata	FI.723/89	Urata Lokali nr.25 në Dardani	Lokal	Objekti i fortë		Lokal afarist nën objektin banesor	Prishtinë	Qytet	1	24.66		€ 10,000				Lokali përdoret për banim nga Xhemile Muja me një vendim të ish menaxhmentit të NSH-së. Sipërfaqja e lokalit eshte marre nga marrveshja per ndryshimin e pronave, ne baze te cilës siperfaqja totale eshte 52.66 prej te cilave 28m2 jane shitur ne SHAL55 dhe kane mbetur edhe 24.66m2.	SHAL 58 refuzim nga Bordi. Refuzim nga Bordi SHAL 61.
18	Prizren	PRZ007	18	PRZ007/18	Sharrprodhimi	FI.302/89	NSh "Sharrprodhimi" - Shitorja në fshatin Kuk, Dragash	Lokal	Objekt i fortë		NSH "Sharrprodhimi" - Shitorja ne fshatin Kuk, Dragash – përfshin lokalin afarist i cili gjendet në përdrejtë të ndërtesës P+1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 134 m^2 që gjendet afër shanisë së fshatit Kuk e ndërtuar në parcelën 422-0 – ZK Kuk, Komuna e Dragashit. Toka ku ndodhet lokali NUK është pjesë e kësaj shitje.	Dragash	Kuk-Fshat	1	134		€ 5,000			1	Pronësia e NSh-së bazohet në bazë të Deklaratës me shkrim të ish-Menaxhmentit të NSH-së. Toka ku ndodhet lokali NUK është pjesë e kësaj shitje. Toka është e regjistruar në emër të Komunës së Dragashit	REFUZIM SHAL 56, Refuzim ne SHAL 59.
19	Prizren	PRZ007	12	PRZ007/12	Sharrprodhimi	FI.302/89	NSh "Sharrprodhimi" - Shitorja në fshatin Baçkë, Dragash	Lokal	Objekt i fortë		NSh "Sharrprodhimi" - Shitorja në fshatin Baçkë në Dragash – përfshin lokalin afarist me një sipërfaqe të përgjithshme prej 60 m^2 e cila gjendet në fshatin Baçkë, e ndërtuar nga NShja në parcelën 354-0 - ZK Baçkë, Komuna e Dragashit. Toka ku ndodhet lokali NUK është pjesë e kësaj shitje.	Dragash	Baçkë-Fshat	1	60.00		€ 5,000			1	Pronësia e NSh-së bazohet në bazë të Deklaratës me shkrim të ish-Menaxhmentit të NSH-së. Toka ku ndodhet lokali NUK është pjesë e kësaj shitje. Toka është e regjistruar në emër të Komunës së Dragashit	Dështim në pagesa SHAL 56
20	Prizren	PRZ043	3	PRZ043/3	Zhupa Reqane	FI.384/89	NSh Zhupa Recane-Shitorja nr.7 ne Lloskvice	Lokal	objekt i fortë		NSh Zhupa Recane-Shitorja nr.7 në Lloskvicë - Prona e regjistruar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së palujshme dhe Kopjes së Planit, që ndodhet në Zonën Kadastrale Lloskvicë, me numër të regjistrës kadastrale P-71813045-01643-2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 104m^2, me kulturë 'ndërtesë'.	Prizren	Lloskvice-fshat	1	104.00		€ 3,500		1		Prona/toka bartet te bleresi gjithashtu ne sip. 104m2. Sipas matjeve interne ne terren të kryera nga AKP, sipërfaqja e objektit rezulton të jetë 73 m^2 (sipërfaqe e matur nga muret e jashtme të objektit). Matjet janë bërë me shirit-metër. Prona gjendet në fshatin Lloskvicë, Komuna e Prizrenit.	Pa oferta 55, SHAL 57 refuzim BD, SHAL 60 Refuzim BD
21	Prizren	PRZ032	4	PRZ032/004	NSH "IT Drateks" - Dragash	FI.508/89	NSh "IT Drateks" – Lokali afarist nr.4 në Dragash	Lokal	objekt i fortë		NSh "IT Drateks" - Lokali afarist nr.4 Dragash – përfshin lokalin afarist që ndodhet në Zonën Kadastrale Dragash, Komuna e Dragashit dhe përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 117 m2 dhe është në katin përdheshë të ndërtesës banesore (P+3) të ndërtuar nga NSh'ja që gjendet në qendër të qytetit të Dragashit. Prona e këtij asetí bazohet në bazë të Deklaratës e ish-Menaxhmentit të NSH-së të datës 12.02.2015 (FAK Nr. Ref. 22-1-2-20). Toka ku ndodhet lokali NUK është pjesë e kësaj shitje.	Dragash	Qytet	1	117.00		€ 7,000	1	1		Informata e rëndësishme për ata të AKP-së Ky lokal me Vendimin e Gjykatës së Rrethit në të datës 10.05.2001 i është ndarë 2 ish-punëtorëve të NSH-së: Refki Piraj dhe Fitim Kurtishi për adaptimin e tij për shfrytëzim për banim. AKP-ja Prizren ka kërkuar Opinion Ligjor nga Departamenti Ligjor i AKP-së falë me lëshur me lokalin afarist të cekur me larë sipas Rënkosës për Veprim AR1477 të datës 14.10.2016 dhe sipas Opinionit Ligjor nga Departamenti Ligjor i AKP-së të datës 09.12.2016 thuhet se AKP-ja mund të vazhdojë me ofertimin e Ligjit të AKP-së që mbështetet edhe shitjen e asetave të NSH-ve. Sipas informatës të 2 ish-punëtorëve e NSH-së: Refki Piraj dhe Fitim Kurtishi kanë bërë Kërkesë për blerjen e banesës me Komisionin e Banesave të AKP-së por kërkesat e tyre janë refuzuar me Vendimin e BD të AKP-së Nr. Ref. BD-09/5 të datës 01.11.2017. Në ndërkohë 2 ish-punëtorët e NSH-së: Refki Piraj dhe Fitim Kurtishi kanë bërë Ankesë në Gjykatën me datën 29.12.2017 kundër	SHAL 55 refuzim nga Bordi, SHAL 58 refuzim nga Bordi, SHAL 61 pa oferta
22	Prizren	PRZ043	2	PRZ043/2	Zhupa Reqane	FI.384/89	NSh Zhupa Recane-Shitorja nr.2 ne Drajciq	Lokal dhe tokë	objekt i fortë		NSh Zhupa Recane-Shitorja nr.2 në Drajciq - Prona e regjistruar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së palujshme për parcelën P-71813022-00965-0 dhe në kopjen e planit, që ndodhet në Zonën Kadastrale Drajciq, përfshin sipërfaqen e përgjithshme prej 189 m^2, prej të cilave 92 m^2 me kulturë shtëpi dhe 107 m^2 me kulturë oborr.	Prizren	Drajciq-fshat	1	92.00	107	€ 3,500		1		Siperfaqja totale e njësise 199 m2. Informatë e rëndësishme: Sipas matjeve interne ne terren të kryera nga AKP, sipërfaqja e objektit (P+0) rezulton të jetë 103 m^2 (sipërfaqe e matur nga muret e jashtme të objektit dhe përfaqëson sipërfaqen e njërës etazh). Matjet janë bërë me shirit-metër.	SHAL 55 refuzim nga Bordi, SHAL 58 refuzim nga Bordi, SHAL 61 pa oferta
23	Prizren	PRZ007	5	PRZ007/5	Sharrprodhimi	FI.302/89	NSh "Sharrprodhimi" - Shitorja në fshatin Bellobrad, Dragash	Lokal	Objekt i fortë		NSh "Sharrprodhimi" - Shitorja në fshatin Bellobrad, Dragash – përfshin lokalin afarist prej 77 m2 me kulturë shtëpi/ndërtesë sipas parcelës 805-0 që ndodhet në Zonën Kadastrale Bellobrad, Komuna e Dragashit .	Dragash	Bellobrad-fshat	1	77.00		€ 3,500		1		Bartet toka ne sip prej 77m2. Informatë e rëndësishme: Gjatë vizitës në terren është vizituar objekti dhe parcela pjesë e shitjes në këtë njësi ku sipas gjendjes faktike në terren konstatohet se: • objekti është ndërtim i fort dhe ka etazhësitë S1+P+0. • Janë bërë matjet me shirit-meter të gabaritit të objektit ku si rezultat i këtyre matjeve kemi sipërfaqen e përafërt prej rreth: S1/ Sperasiv= S=46m²; Përdhesë/c= S=46m². Sipërfaqja e përgjithshme e objektit është S=108m². Shitorja në Bellobradë është leshuar me qira nga ana e AL-ja.	SHAL 55 refuzim nga Bordi, SHAL 58 refuzim nga Bordi, SHAL 61 pa oferta
24	Prizren	PRZ007	14	PRZ007/14	Sharrprodhimi	FI.302/89	NSh "Sharrprodhimi" - Lokali afarist Nr.4 në Dragash	Lokal	Objekt i fortë		NSh "Sharrprodhimi" - Lokali afarist Nr.4 në Dragash – përfshin lokalin afarist me sipërfaqe të përgjithshme prej 63.44 m2 që ndodhet në katin përdheshë te objektit banesor P+3 të ndërtuar nga NSH ja, i cili objekt gjendet përballë Qendrës së Punësimit të komunës së Dragashit, Prona e NSH-së bazohet në bazë të Deklaratës me shkrim të ish-Menaxhmentit të NSH-së. Toka ku ndodhet lokali NUK është pjesë e kësaj shitje.	Dragash	Dragash-qytetë	1	63.44		€ 7,000		1		Pronësia e NSh-së bazohet në bazë të Deklaratës me shkrim të ish-Menaxhmentit të NSH-së. Toka ku ndodhet lokali NUK është pjesë e kësaj shitje.	SHAL 55 refuzim nga Bordi, SHAL 58 refuzim nga Bordi, SHAL 61 pa oferta
25	Prizren	PRZ007	4	PRZ007/4	Sharrprodhimi	FI.302/89	NSh "Sharrprodhimi" - Shitorja në fshatin Buçe, Dragash	Lokal	Objekt i fortë		NSh "Sharrprodhimi" - Shitorja ne fshatin Buçe, Dragash – përfshin lokalin afarist prej 72 m2 (me kulturë shtëpi ndërtesë) të regjistruar në emër të NSh-së në parcelë 84-2 në Zonën Kadastrale Buçe, Komuna e Dragashit	Dragash	Buçe-fshat	1	72		€ 3,500		1		Bartet toka ne sip prej 72m2. Informatë e rëndësishme: Gjatë vizitës në terren është vërtetuar se objekti dhe parcelat pjesë e shitjes së kësaj njësie sipas gjendjes faktike në terren është si në vijim: • Objekti është ndërtim i fort dhe ka etazhësitë P+0 • Është bërë matjet interne nga AKP me shirit metër e gabaritit të objektit ku si rezultat i kësaj matje kemi sipërfaqen e përafërt prej rreth 60m2. Shitorja në Buçe - është leshuar me qira nga ana e AL-ja	SHAL 55 refuzim nga Bordi, SHAL 58 refuzim nga Bordi. Refuzim ne SHAL 61

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-176/2**

Vërejtje:

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.

Nr. Ref. BD-176/3

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 27 shkurt 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Procesverbali i mbledhjes së datës 27 janar 2023 nëpërmjet kësaj aprovohet si procesverbal i mbledhjes së Bordit të cekur më lartë.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi sipas procedurave procesverbalin e mbledhjes paraprake të mbajtura me 27 janar 2023. Ky dokument aprovohet në pajtim me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenin 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO - Agjencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska agencija za privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo - ZQ / HQ / GS - Prishtinë - Priština

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-176/4**

<u>Vërejtje:</u>

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.

Nr. Ref. BD-176/5

Në bazë të neneve 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 5.2 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-021 Për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike, nenit 23 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit-ZKA, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 shkurt 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Plani i Veprimit të AKP-së për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Raportin e Auditimit - Të hyrat nga qiraja në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për periudhën 2012-2021.**

II. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi ka shqyrtuar dokumentin e përgatitur nga Menaxhmenti në bashkëpunim me Komitetin e Auditimit.

Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe obligimet që dalin nga aty për përmbushjen e të gjeturave nga auditimi, Bordi ka shqyrtuar Planin e Veprimit të AKP-së për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Raportin e Auditimit - Të hyrat nga qiraja në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për periudhën 2012-2021.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-176/6

Në bazë të neneve 15.1 dhe 6A të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Vendimi përfundimtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 19/121 të datës 25 Janar 2023 për shpronësimin e pronave së paluajtshme nr.1403-0 dhe nr.1407-0 ZK Obrangjë dhe nr.315-0 ZK Surkish të NSH Kooperativa Bujqësore Përparimi (PRN019), Podujevë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 shkurt 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet transferimi i pronave të NSH Kooperativa Bujqësore Përparimi (PRN019), Podujevë me detajet e pronës: Prona e paluajtshme nr.1403-0 dhe nr.1407-0 ZK Obrangjë për ndërtimin e lokacionit për "Varrezat e Qytetit" dhe prona nr.315-0 ZK Surkish për ndërtimin e "infrastrukturës Shëndetësore", në emër të Komunës së Podujevës në përputhje me Vendimin Përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Shpronësim nr. 19/121, të datës 25.01.2023.**

I. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e kërkesës për shpronësim të pronës shoqërore sipas kërkesës së Komunës së Podujevës për interes publik sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vemdimi.

Më datë 25 janar 2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendimin Përfundimtar me nr. 19/121 përmes së cilit është miratuar shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të NSH Kooperativa Bujqësore Përparimi (PRN019), Podujevë, prona me nr.1403-0 me sipërfaqe prej 63,277 m2 dhe prona me nr.1407-0 ZK me sipërfaqe prej 40,283 m2 ZK Obrangjë për ndërtimin e lokacionit për "Varrezat e Qytetit" si dhe prona me nr.315-0 ZK Surkish me sipërfaqe prej 69,934 m2 për ndërtimin e "infrastrukturës Shëndetësore" në emër të Komunës së Podujevës.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë, dhe pasi që janë plotësuar kushtet ligjore, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-176/7

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullores Nr. 05/2020 të datës 22.12.2020 mbi qiradhënie të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 shkurt 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e qiramarrësit Rroni Fer sh.p.k. lidhur me renovimin e objektit në **sipërfaqe prej 75m² dhe peshores në sipërfaqe prej 84m² për asetin e NSH Metaliku-Ena Gjakovë.**

II. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit lidhur me kërkesën e operatorit Rroni Fer për renovimin e objektit dhe ndërtimin e peshores. AKP/NJMKAD me datë 14 shkurt 2023 ka pranuar kërkesën nga qiramarrësi Rroni Fer, lidhur me lejimin e punimeve në objekt me sipërfaqe prej 75m², me arsyetimin se: për shkaqe të sigurisë duhet të rinovohet objekti ekzistues me bazë të qëndrueshme për shkak se në hapësirat aktuale muret e objektit janë shumë të paqëndrueshme dhe është rrezik të shemben. Andaj ky investim është i domosdoshëm dhe nuk e ndryshon strukturën paraprake.

Afër hallës për prodhimin e telit ku është duke u renovuar objekti me sipërfaqe prej 75m², qiramarrësi ka filluar punimet për peshore në sipërfaqe prej 84m² e cila i nevojitet për ushtrimin e veprimtarisë biznesore.

Njësia për Monitorim, Kontroll dhe Administrim Direkt e AKP-së, ka marr konfirmimin edhe prej Bordit të Ndërmarrjes Metaliku sa i përket hapësirave për të cilat qiramarrësi i ka potencua në shkresën e datës 11.02.2023. Bordi i Ndërmarrjes konfirmojnë se peshorja është nëntokësore dhe me lartësi të vogël mbi tokë. Sa i përket objektit përcjellës të peshores është objekt i cili ka ekzistua edhe më herët por që ka qenë i dëmtuar dhe i rrezikshëm për përdorim pasi që ka qenë pothuaj i rrënuar në tërësi dhe objekti është ngrit në themelet ekzistuese.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

REPUBLIKA E KOSOVËS - Agjencia Kosovare e Privatizimit - ZQ / HQ / GS - Prishtinë - Prishtina
REPUBLIKA KOSOVA - Privatizacija e Agencisë Kosovës - REPUBLIC OF KOSOVO

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-176/8

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 shkurt 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet ankesa e qiramarrësit Rroni Fer sh.p.k. kundër vendimit të Bordit të Drejtorëve** të AKP-së BD-175/12 për përcaktimin e vlerës dhe hapësirës së qirasë për asetin oborri para hallës së ndërtuar për zhvillim për asetin e NSH Metaliku-Ena Gjakovë.

I. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit lidhur me ankesën e operatorit Rroni Fer kundër vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së BD-175/12 për përcaktimin e vlerës dhe hapësirës së qirasë për asetin oborri para hallës së ndërtuar për zhvillim për asetin e NSH Metaliku-Gjakovë.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e dhjetorit 2022 ka udhëzuar menaxhmentin që të inicioj vlerësimin e çmimit të qirasë për qiradhënie direkte të asetit të NSH Metaliku, respektivisht të trajtoj kërkesat e qiramarrësve Rroni Fer për qiradhënie direkte të oborrit para hallës së ndërtuar për zhvillim.

Qiraja e vlerësuar për asetin e NSH Metaliku Gjakovë nga komisioni i emëruar nga Drejtori Menaxhues është bërë bazuar në gjendjen në terren, informatat mbi qiratë e natyrës së tillë, krahasimet e pronave të tilla si dhe gjendja e pronës për të cilën është bërë vlerësimi si dhe duke bërë përshtatjet e nevojshme bazuar në rregulloren për qiradhënie. Bazuar në gjendjen në terren dhe matjet e bëra nga Njësia e Kadastrit, oborri përfshin sipërfaqen prej 14939 m² prej të cilave 9779 m² janë plato e asfaltuar dhe 5160 m² është hapësirë e gjelbëruar. E tërë kjo hapësirë është e rrethuar nga qiramarrësi Rroni Fer dhe nuk mund të shfrytëzohet nga qiramarrësit e tjerë, prandaj komisioni vlerësues gjatë vlerësimit ka marrë për bazë gjendjen faktike në terren dhe ka bërë vlerësimin për tërë hapësirën e cila shfrytëzohet nga qiramarrësi Rroni Fer. Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vlerëson se çmimi i përcaktuar nga Komisioni ka qenë i drejtë dhe për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-176/9

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 shkurt 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet kërkesa e qiramarrësit Alfa Minerals që kontrata për qiradhënie të aseteve të dhëna me qira në korrik të vitit 2022 të jetë nga data e nënshkrimit të kontratës;**

II. **Refuzohet kërkesa e qiramarrësit Mac Solutions që kontrata e qirasë për qiradhënie të asetit me sipërfaqe prej 53856 m² të jetë nga data 01.05.2023.**

III. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit lidhur me shqyrtimi e kërkesës së qiramarrësit Alfa Minerals për shtyrjen e afatit për fillimin e kontratave të qirasë.

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2023 ka nxjerr vendimin numër BD 175 -12 sipas të cilit vendim ka aprovuar qiradhënien për këtë aset në vlerën e caktuar dhe se qiradhënia do të fillon nga data 01.02.2023.

Bordi i Përkohshëm Menaxhues i Ndërmarrjes Metaliku ka njoftuar qiramarrësin për vendimin e Bordit të Drejtorëve dhe ka dorëzuar vendimin te qiramarrësi. Ndërkohë janë mbajtur disa takime në mes të Menaxhmentit të AKP-së dhe këtij qiramarrësi ku është diskutuar për obligimet që ka ky qiramarrës, për elementet kimike të cilat janë të zhvendosura në një hapësirë që ky qiramarrës ka me qira si dhe për vendimin e Bordit të Drejtorëve nr. BD 175 -12 për qiradhënie të hapësirës prej 53856 m². Sa i përket rezervarëve të gazit 6 copa ato bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së numër BD-167 -41 të datës 28 korrik 2022 iu janë dhëne me qira qiramarrësit Alfa Minerals por kontrata ende nuk është nënshkruar për shkak të borxheve që ka ky qiramarrës. Ky qiramarrës ka kërkuar që të bëhet edhe njëherë kontrollimi i matjeve në terren, që data e fillimit të qirasë për asetet për të cilat nuk i ka nënshkruar kontratat më herët të jetë nga data e nënshkrimit te kontrates si dhe që afati për fillimin e kontratës së qirasë për sipërfaqen prej 53856 m² të jetë nga 01.05.2023 e jo nga data 01.02.2023 datë e cila është e përcaktuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Pas dorëzimit të vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe kërkesës për qiramarrësin se para se të nënshkruan kontratat e qirasë duhet të kryen obligimet e mbetura për qira, aksionari i qiramarrësit Mac Solutions ka pasur disa kërkesa dhe korrespodenca me Drejtorin Menaxhues të AKP-së dhe ku ndër të tjera kërkon që të bëhet edhe njëherë kontrollimi i matjeve në terren, që data e fillimit të qirasë për asetet për të cilat nuk i ka nënshkruar kontratat më herët të jetë data e nënshkrimit të kontratës dhe që afati për fillimin e kontratës së qirasë për sipërfaqen prej 53856 m² të jetë nga 01.05.2023 e jo nga data 01.02.2023 datë e cila është e përcaktuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Kurse sa i përket afatit të fillimit të kontratave ky afat rrjedh nga vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe nuk mund të shtyhet pa ndonjë arsyetim të cilin arsyetim deri më tani ky qiramarrës nuk e ka sjellë.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-176/10

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, nenit 42 të Ligjit nr. 03/154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 04/2020 për Politikat dhe procedurat e likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 shkurt 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aseti nr. P-73105038-01397-0 me sipërfaqe prej 63 m² ZK Junik dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti i NSH 16 Qershori.**

II. **Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

III. **Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Ngastra kadastrale nr. P-73105038-01397-0 me sipërfaqe prej 63 m² ZK Junik që është objekt i kësaj kërkese është evidentuar si rrugë publike e asfaltuar brenda ZK Junik.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike."

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit.Po ashtu, Autoriteti i Likuidimit i ka dërguar Kryetarit të Komunës së Junikut më datë 25 gusht 2022, kërkesë që të konfirmojë që parcela shfrytëzohet si rrugë ku edhe është pranuar përgjigje më datë 12 shtator 2022, përmes së cilës është konfirmuar se kjo parcelë shfrytëzohet si rrugë publike.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-176/11

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 shkurt 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e N.Sh. Kombinati i Lëkure Këpucëve (në likuidim) PEJ173, nga Rajoni i Pejës.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të PEJ173 NSh "Kombinati i Lëkure Këpucëve" (Në Likuidim).

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-176/12

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 shkurt 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e N.Sh.P.T. "Vinex" GJI065 (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të Likuidimit të GJI065 N.Sh.P.T. "Vinex" (Në Likuidim).

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-176/13

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 shkurt 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "Ndërmarrja Pyjore Industriale Tregtare Gjeravica" PEJ146 (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.**

I. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të pjesshme të fondeve të Likuidimit të PEJ146 NSh "Ndërmarrja Pyjore Industriale Tregtare Gjeravica" (në Likuidim).

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës